



رئاسة الشؤون الدينية
بالمسجد الحرام والمسجد النبوي

shqip

ألّباني

كَيْفِيَّةُ صَلَاةِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

Forma e namazit të Profetit ﷺ



Shejhu i nderuar
Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi

كَيْفِيَّةُ صَلَاةِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ

Forma e namazit të Profetit ﷺ

لَفَضِيلَةِ الشَّيْخِ الْعَلَامَةِ
عَبْدِ الْعَزِيزِ بْنِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ بَازٍ
غَفَرَ اللَّهُ لَهُ وَلِوَالِدَيْهِ وَلِلْمُسْلِمِينَ

Shejhu i nderuar
Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Forma e namazit të Profetit ﷺ

Shejhu i nderuar

Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Çdo lavdërim i takon vetëm Allahut, ndërsa salavatet dhe selamet qofshin për robin e Tij dhe të Dërguarin e Tij, profetin tonë, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

Këto janë disa fjalë të përmbledhura lidhur me sqarimin e formës së namazit të Profetit ﷺ; kam dashur t'ua paraqes të gjithë muslimanëve e muslimaneve, në mënyrë që çdo kush që i mëson ato të përpiqet ta pasojë shembullin e Profetit ﷺ në këtë adhurim, duke u bazuar në hadithin e Profetit ﷺ:

(صَلُّوا كَمَا رَأَيْتُمُونِي أُصَلِّي).

"Faluni ashtu siç më keni parë mua duke u falur!"¹ Më poshtë i paraqesim lexuesit formën e abdesit dhe të namazit:

1- Të marrë abdes të plotë, që do të thotë të marrë abdes ashtu siç e ka urdhëruar Allahu i

¹ Shënon Buhariu, nr. 605.

Lartësuar, duke zbatuar fjalën e Tij:

﴿يَتَأْتِيهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ...﴾.

"O besimtarë! Kur të çoheni për të faluar namazin, lajini fytyrat dhe duart së bashku me bërrylat, fërkojini kokat (me duar të lagura) dhe lajini këmbët deri te njejt..." (El Maide, 6) ...deri në fund të ajetit.

Si dhe fjalën e Profetit ﷺ:

(لَا تُقْبَلُ صَلَاةٌ بِغَيْرِ طُهُورٍ).

"Namazi pa abdes nuk pranohet."¹

Si dhe fjalën e Profetit ﷺ drejtuar personit që nuk e fali mirë namazin:

(إِذَا قُمْتَ إِلَى الصَّلَاةِ، فَأَسْبِغِ الوُضُوءَ).

"Kur të çohesh për të falur namazin, merr abdes të plotë!"²

2- Ai që falet duhet të drejtohet nga kibla -Qabja-, kudo që të jetë, me tërë trupin, duke e vendosur me zemër se po kryen namazin që synon, qoftë farz (i detyruar) apo nafile (vullnetar). Dhe nuk e shqipton nijetin me gjuhë, sepse shqiptimi me gjuhë nuk është i ligjësuar, por bidat, ngase Profeti ﷺ nuk e shqiptonte nijetin, as shokët e tij (Allahu

¹ Shënon Muslimi, nr. 224.

² Shënon Buhariu, nr. 5782.

qoftë i kënaqur me ta!). Gjithashtu ai duhet të vendosë para vetes një sutër (pengesë) dhe të falet drejt saj, nëse është imam ose person që po falet i vetëm. Kthimi drejt kiblës është kusht në namaz, me përjashtim të disa rasteve specifike që janë të sqaruara në librat e dijetarëve.

3- E merr tekbirin fillestar duke thënë: "Allahu ekber" me shikimin drejt vendit të sexhdes.

4- I ngren duart gjatë tekbirit deri te supet ose deri te veshët.

5- I vendos duart në gjoks; dorën e djathtë mbi shpinën, kyçin dhe parakrahun e dorës së majtë, sepse kështu është vërtetuar nga Profeti ﷺ.

6- Është sunet të lexohet duaaja hyrëse, e cila është:

(اللَّهُمَّ بَاعِدْ بَيْنِي وَبَيْنَ خَطَايَايَ، كَمَا بَاعَدْتَ بَيْنَ الْمَشْرِقِ وَالْمَغْرِبِ، اللَّهُمَّ نَقِّنِي مِنَ الْخَطَايَا كَمَا يُنَقَّى الثَّوْبُ الْأَبْيَضُ مِنَ الدَّنَسِ، اللَّهُمَّ اغْسِلْ خَطَايَايَ بِالْمَاءِ وَالثَّلْجِ وَالْبَرَدِ).

"Allahumme baid bejni ve bejne hatajaje kema ba'adte bejnel meshriki vel magrib. Allahumme nekkini minel hataja kema junekkath-theubul ebjedu mined-denes. Allahummegsil hatajaje bil mai veth-thelxhi vel bered." - "O Allah! Më largo prej mëkateve të mia siç e ke larguar lindjen prej perëndimit! O Allah! Më pastro prej mëkateve siç pastrohet rroba e bardhë prej njollave! O Allah! M'i

laj mëkatet me ujë, borë dhe akull)!"¹

Nëse dëshiron, në vend të kësaj mund të thotë:

(سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، وَتَبَارَكَ اسْمُكَ، وَتَعَالَى جَدُّكَ، وَلَا إِلَهَ غَيْرُكَ).

"Subhaneke Allahumme ve bihamdike, ve tebarekesmuke, ve teala xhedduke, ve la ilahe gajruke." - "O Allah! Ti je pa të meta. Ty të bëj lavdi! Emri Yt është i bekuar, Madhëria Jote është e Lartësuar dhe askush pos Teje s'ka të drejtë të adhurohet!"² Nëse thotë ndonjërin nga duatë (lutjet) e tjera të hapjes së namazit që janë të transmetuara dhe të vërtetuara nga Profeti ﷺ, nuk ka asgjë të keqe. Madje më e mira është që herë të bëjë këtë, e herë atë, sepse kjo është forma më e plotë e pasimit të Profetit ﷺ. Pastaj thotë: "Eudhu bil-lahi mineshejtani-raxhim. Bismil-lahir-rahmanir-rahim." - "Kërkoj mbrojtjen e Allahut ndaj shejtanit të mallkuar. Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!", pastaj lexon suren el Fatiha, duke u bazuar në fjalën e Profetit ﷺ:

(لَا صَلَاةَ لِمَنْ لَمْ يَقْرَأْ بِفَاتِحَةِ الْكِتَابِ).

"Nuk ka namaz ai që nuk e këndon suren el Fatiha."³ Pas saj thotë: "Amin" me zë, në namazet me zë, dhe pa zë, në namazet pa zë. Më pas lexon

¹ E shënojnë Buhariu, nr. 744 dhe Muslimi, nr. 598.

² Shënon Muslimi, nr. 399.

³ Shënon Buhariu, nr. 756.

çfarë të dëshirojë prej pjesëve të Kuranit. Më e mira është që pas sures el Fatiha, në drekë, ikindi dhe jaci, të lexojë nga suret e mesme, në sabah nga suret e gjata, ndërsa në aksham, herë nga të gjatat e herë nga të shkurtrat, duke vepruar sipas haditheve të transmetuara në këtë çështje.

7- Bie në ruku duke thënë: "Allahu ekber", i ngren duart deri te supet ose deri te veshët, në ruku e mban kokën drejt me shpinën, duart i vendos mbi gjunjë dhe gishtërinjtë i mban të hapur. Qëndron i qetë në ruku dhe thotë: "Subhane rabbijeladhim" - I pa të meta je, Zoti im Madhështor". Më e mira është ta përsërisë këtë dhikër tri herë ose më shumë, dhe është e pëlqyeshme që bashkë me këtë të thotë edhe:

(سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ وَبِحَمْدِكَ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي).

"Subhanekall-llahumme ve bihamdike, Allahummegirli." - "Pa të meta je, o Allah! Ty të bëj lavdi! O Allah, më fal!").¹

8- Çohet nga rukuja duke i ngritur duart deri te supet ose deri te veshët, duke thënë: "Semiall-llahu limen hamideh!" - "Allahu e dëgjoftë lavdinë e atij që i bën lavdi!" Këtë e thotë nëse është imam ose person që po falet vetëm. Gjatë qëndrimit në këmbë thotë:

¹ E shënojnë Buhariu, nr. 817 dhe Muslimi, nr. 484.

(رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ حَمْدًا كَثِيرًا طَيِّبًا مُبَارَكًا فِيهِ مِلَّةَ السَّمَوَاتِ وَمِلَّةَ الْأَرْضِ،
وَمِلَّةَ مَا شِئْتَ مِنْ شَيْءٍ بَعْدُ).

"Rabbena ve lekel-hamd hamden kethiran tajjiben mubaraken fihi, mil'e-s-semavati vel erdi, ve mil'e ma shi'te min shej'in ba'd." - "Zoti ynë, Ty të takon lavdia, lavdi e panumërt, e dëlirë nga syfaqësia dhe e pafundme, sa të mbushet hapësira e qiejve dhe e tokës, si edhe po aq sa çfarëdo tjetër që dëshiron Ti, pas kësaj."¹

Ndërsa nëse falet pas imamit (si xhematli), kur ta ngrejë kokën nga rukuja, thotë: "Rabbena ve lekel hamd" deri në fund të asaj që u përmend më sipër. E nëse shton secili prej tyre: d.m.th. imami, ai që falet pas imamit (xhematliu) dhe ai që falet vetëm:

(أَهْلَ الْقَنَاءِ وَالْمُجِدِّ، أَحَقُّ مَا قَالَ الْعَبْدُ، وَكُنَّا لَكَ عَبْدٌ: اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا
أَعْطَيْتَ، وَلَا مُعْطِي لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجُدُّ).

"Ehleth-thenai velmexhdi, ehakku ma kalel abdu, ve kul-luna leke abd: Allahumme la mania lima a'tajte ve la mu'tije lima mena'te ve la jenfeu dhel-xheddi minkel-xhedd!" - "O i Denji për lavdërim dhe lavdi! Fjala më e drejtë që e thotë robi, dhe të gjithë ne jemi robër të Tu, është: O Allah, atë që jep Ti askush e pengon, e atë që nuk e jep Ti askush nuk e jep. Askujt nuk mund t'i bëjnë dobi

¹ E shënojnë Buhariu, nr. 711 dhe Muslimi, nr. 598.

pasuria dhe prejardhja në raport me Ty."¹ Kjo është diçka e mirë, sepse është e vërtetuar prej Profetit ﷺ se e ka thënë këtë dhikër.

Pëlqehet që secili prej tyre: d.m.th. imami, ai që i falet pas imamit (xhematliu) dhe ai që falet i vetëm, t'i vendosë duart në gjoks, ashtu siç vendosen gjatë qëndrimit në këmbë para rukusë, sepse hadithi i Vail ibn Huxhrit dhe Sehl ibn Sadit (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) dëshmon se Profeti ﷺ e bënte një gjë të tillë.

9- Thotë: "Allahu ekber" dhe bie në sexhde, i vendos gjunjët para duarve, nëse e ka të lehtë kështu, e nëse e ka të vështirë, i vendos duart para gjunjëve, duke i drejtuar majat e gishtërinjve të këmbëve dhe gishtërinjtë e duarve nga kibla, me gishtërinjtë e duarve të bashkuar e të shtrirë. Sexhden e bën me shtatë gjymtyrë: ballin bashkë me hundën, shuplakat e duarve, gjunjët dhe majat e gishtërinjve të këmbëve. Dhe thotë: "Subhane rabbijel ala"- "I Patëmeta është Zoti im më i Larti". Është sunet ta thotë këtë tri herë ose më shumë, dhe pëlqehet që, krahas kësaj, të thotë:

(سُبْحَانَكَ اللَّهُمَّ رَبَّنَا وَبِحَمْدِكَ، اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِي).

"Subhanekall-llahumme rabbena ve bihamdike, Allahummegfir li." - "Pa të meta je, o Allah! Zoti ynë! Ty të bëj lavdi! O Allah, më fal!" Në sexhde pëlqehet

¹ Shënon Muslimi, nr.477.

të bëhet sa më shumë lutje, sepse Profeti ﷺ ka thënë:

(أَمَّا الرُّكُوعُ، فَعَظِّمُوا فِيهِ الرَّبَّ، وَأَمَّا السُّجُودُ، فَاجْتَهِدُوا فِي الدُّعَاءِ، فَقِيمَنَّ أَنْ يُسْتَجَابَ لَكُمْ).

"Kur jeni në ruku, madhërojeni Zotin, kurse në sexhde përpikuni të bëni dua sa më shumë, se me siguri do t'ju pranohen."¹

Dhe i kërkon Zotit të tij nga të mirat e dynjasë dhe ahiretit. Lutja në sexhde bëhet edhe në namazet farz edhe në namazet nafile. Në sexhde duhen larguar krahët nga ijet, barku nga kofshët dhe kofshët nga kërcinjtë, parakrahët mbahen të ngritur nga toka, sepse Profeti ﷺ ka thënë:

(اعْتَدِلُوا فِي السُّجُودِ، وَلَا يَبْسُطْ أَحَدُكُمْ ذِرَاعَيْهِ انْهِسَاطَ الْكَلْبِ).

"Bëjeni mirë sexhden dhe askush të mos i shtrijë krahët sikurse qeni." (11)²

10- E ngren kokën duke thënë tekbirin, e shtrin këmbën e majtë dhe ulet mbi të, ndërsa këmbën e djathtë e mban të ngritur, duart i vendos mbi kofshët dhe gjunjët, dhe thotë:

(رَبِّ اغْفِرْ لِي وَارْحَمْنِي وَاهْدِنِي وَارْزُقْنِي وَعَافِنِي وَاجْبُرْنِي).

"Rabbigfirli verhamni vehdini verzukni ve afini vexhburni." - "O Zot, më fal, më mëshiro, më

¹ Shënon Muslimi, nr. 479.

² E shënojnë Buhariu, nr. 788 dhe Muslimi, nr. 493.

udhëzo, më jep shëndet dhe më përmirëso!"¹
Qëndron ulur derisa të qetësohen gjymtyrët.

11- Pastaj bën sexhden e dytë duke thënë: "Allahu ekber", dhe vepron në të njëjtë si në sexhden e parë.

12- Ngrihet duke thënë: "Allahu ekber" dhe bën një ulje të shkurtër si ulja ndërmjet dy sexhdeve; kjo quhet ulja e pushimit. Kjo ulje është e pëlqyeshme dhe nëse e lë, nuk ka gjynah për të. Në këtë ulje nuk ka dhikër as lutje. Pastaj çohet në këmbë për rekatin e dytë duke u mbështetur mbi gjunjët nëse e ka të lehtë kështu, e nëse e ka të vështirë, mbështetet në tokë. Pastaj lexon suren el Fatiha dhe pas saj çfarë të mundet nga Kurani, e më pas vepron siç ka vepruar në rekatin e parë.

13- Nëse namazi është me dy rekate, si namazi i sabahut, i xhumasë dhe i dy bajrameve, pas ngritjes nga sexhdja e dytë ulet duke e mbajtur këmbën e djathtë drejt, ndërsa të majtën të shtrirë. Dorën e djathtë e vendos mbi kofshën e djathtë te pjesa afër gjurit, i mbledh të gjithë gishtat, përveç gishtit tregues dhe bën shenjë e teuhidit (monoteizmit) me të. E nëse mbledh gishtin e vogël dhe gishtin e unazës, ndërsa gishtin e madh dhe gishtin e mesëm i bashkon me njëri-tjetrin, duke formuar një lloj rrethi dhe bën shenjë me gishtin tregues, kjo është gjë e mirë. Të dyja mënyrat janë të vërtetuara nga

¹ E shënojnë Tirmidhiu, nr. 284, Ebu Davudi, nr. 850 dhe Ibn Maxhe, nr. 898.

Profeti ﷺ, dhe më e mira në këtë rast është të bëjë herë këtë e herë atë. Ndërkohë e vendos dorën e majtë mbi kofshën e majtë dhe mbi gjurin dhe lexon teshehudin, që është:

(التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ، السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ، السَّلَامُ عَلَيْنَا وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ).

"Et-tehijjatu lil-lahi vea-saleuatu, vet-tajjibatu, es-selamu 'alejke ejjuhen-nebijju ve rahmetull-llahi ve berakatuhu, es-selamu 'alejna ve 'ala 'ibadil-lahis-salihin, eshedu en la ilahe il-lallah, ve esh'hedu enne Muhammeden 'abduhu ue rasuluhu." - "Nderimet, lutjet dhe punët e mira janë për Allahun! Paqja qoftë mbi ty, o i Dërguar, si dhe mëshira e bekimet e Allahut! Paqja qoftë me ne dhe me robërit e drejtë të Allahut! Dëshmoj se nuk ka të adhuruar (tjetër me të drejtë) përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij!" Dhe pastaj thotë:

(اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ؛ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ، وَبَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ، كَمَا بَارَكْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَعَلَى آلِ إِبْرَاهِيمَ؛ إِنَّكَ حَمِيدٌ مَجِيدٌ).

"Allahumme šal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammedin, kema šal-lejte ala Ibrahimë ue ala ali Ibrahimë, inneke Hamidun Mexhid. Allahumme barik ala Muhammedin ue ala ali Muhammedin,

kema barakte ala Ibrahimë ve ala ali Ibrahimë, inneke Hamidun Mexhid." - "O Allah, shpëtoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit ashtu siç shpëtove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, se me të vërtetë Ti je i Lavdëruar e i Madhërishëm. O Allah, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit ashtu siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, se me të vërtetë Ti je i Lavdëruar dhe i Madhërishëm."¹

Dhe i kërkon mbrojtje Allahut ta ruajë nga katër gjëra dhe thotë:

(اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابِ جَهَنَّمَ، وَمِنْ عَذَابِ الْقَبْرِ، وَمِنْ فِتْنَةِ الْمَحْيَا وَالْمَمَاتِ، وَمِنْ شَرِّ فِتْنَةِ الْمَسِيحِ الدَّجَالِ).

"Allahumme inni e'udhu bike min adhabi xhehennem, ve min adhabil qabr, ve min fitnetil mahja vel memat! Ve min sherri fitnetil mesihid-dexh-xhal." - "O Allah! Më ruaj nga dënimi i Xhehenemit! Më ruaj nga dënimi i varrit! Më ruaj nga sprovat gjatë jetës e pas vdekjes! Më ruaj nga sherri i sprovës së mesihut Dexhal!"²

Pastaj vazhdon e lutet për gjërat që dëshiron nga të mirat e dynjasë dhe ahiretit, dhe nëse lutet për prindërit e tij ose për muslimanë të tjerë, nuk ka asnjë të keqe, qoftë në namazet farz apo nafile; për shkak të kuptimit të përgjithshëm të hadithit të

¹ E shënojnë Buhariu, nr. 797 dhe Muslimi, nr. 402,

² E shënojnë Buhariu, nr. 1311 dhe Muslimi, nr. 588.

Profetit ﷺ, që e përcjell Ibn Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), kur ia mësoi teshehudin:

(ثُمَّ لِيَتَخَيَّرَ مِنَ الدُّعَاءِ بَعْدَ أَعْجَبَهُ إِلَيْهِ فَيَدْعُو).

"Pastaj le të përzgjedhë nga lutjet atë që i pëlqen më shumë, e le të lutet."¹ Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet:

(ثُمَّ لِيَخْتَرِ مِنَ الْمَسْأَلَةِ مَا شَاءَ).

"Pastaj le të përzgjedhë çfarëdo lutjeje që dëshiron."²

Kjo përfshin gjithçka që i sjell dobi njeriut në këtë dynja dhe në ahiret. Pastaj jep selam në të djathtë dhe në të majtë duke thënë: "Esselamu alejkum ue rahmetullah", "Esselamu alejkum ue rahmetullah."

14 - Nëse namazi është trerekatësh, si namazi i akshamit, ose katërrekatësh si i drekës, i ikindisë dhe i jacisë, ai e lexon teshehudin e përmendur më sipër, së bashku me dërgimin e salavateve mbi Profetin ﷺ; pastaj çohet në këmbë, duke u mbështetur mbi gjunjë, duke i ngritur duart deri në nivelin e shpatullave ose të veshëve, duke thënë: "Allahu ekber" (Allahu është më i Madhi!), e pastaj i vendos ato, pra, duart, mbi gjoks, ashtu siç u sqarua më herët, dhe lexon vetëm el Fatihanë. E nëse, herë

¹ Shënon Nesaiu, nr. 1298.

² Shënon Muslimi, nr. 402.

pas here, në rekatin e tretë dhe të katërt të drekës lexon diçka më tepër se elvFatihaja, s'ka asgjë të keqe, ngase për këtë ka transmetime që dëshmojnë se Profeti ﷺ e ka bërë, siç ceket në hadithin e Ebu Seidit (Allahu qoftë i kënaqur me të!). E nëse pas teshehudit të parë e lë pa i thënë salavatet për Profetin ﷺ, s'ka gjë të keqe, sepse ajo është e pëlqyer dhe jo e detyrueshme në teshehudin e parë. Pastaj, pas reaktit të tretë të akshamit dhe pas të katërtit në namazin e drekës, ikindisë dhe jaciesë, bën teshehud ashtu siç bëhet në namazin dyrekatësh. Më pas jep selam në të djathtë, e pastaj në të majtë, dhe i kërkon falje Allahut tri herë dhe thotë:

(اللَّهُمَّ أَنْتَ السَّلَامُ وَمِنْكَ السَّلَامُ، تَبَارَكْتَ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ).

"Allahuhumme entes selamu ve minkes selamu tebarakte ja dhel xhelali uel ikram." - "O Allah! Ti je Paqedhënësi dhe vetëm prej Teje vjen paqja! Ti je përgjithmonë i Begatë, o Zotëruesi i madhështisë dhe nderimit!"¹ Këtë e thotë para se të kthehet drejt njerëzve, nëse është imam, dhe pastaj thotë:

(لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ، وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ، اللَّهُمَّ لَا مَانِعَ لِمَا أَعْطَيْتَ، وَلَا مُعْطِيَ لِمَا مَنَعْتَ، وَلَا يَنْفَعُ ذَا الْجَدِّ مِنْكَ الْجَدُّ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ، وَلَا نَعْبُدُ إِلَّا إِيَّاهُ، لَهُ التَّعَمُّدُ وَلَهُ الْفَضْلُ، وَلَهُ الشَّانُ

¹ Shënon Muslimi, nr. 591.

الحَسَنُ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ وَلَوْ كَرِهَ الْكَافِرُونَ).

"La ilahe il-lallahu vahdehu la sherike lehu, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kul-li shej'in Kadir. La haule ve la kuvete il-la bil-lah. Allahumme la mania lima a'tajte ve la mu'tije lima mena'te ve la jenfeu dhel xheddi minkel-xhed. La ilahe il-lallah, ve la na'budu il-la ijjahu, lehun-ni'metu ve lehul fadlu ve lehu-th-thenaul hasen, la ilahe il-lallah muhlisine lehuddin ve leu kerihel kafirune." - "S'ka të adhurar të denjë përveç Allahut, të Vetmit, që nuk ka ortak. Atij i takon sundimi dhe lavdi, Ai ka fuqi për çdo gjë. S'ka ndryshim e as fuqi, përveçse me Allahun. O Allah! Askush nuk mund të pengojë nëse Ti jep dhe askush nuk mund të japë nëse Ti pengon. Askujt nuk mund t'i bëjnë dobi pasuria dhe prejardhja në raport me Ty. S'ka të adhurar të denjë përveç Allahut dhe nuk adhurojmë askënd përveç Tij. E Tija është çdo mirësi, e Tija është çdo vlerë dhe Atij i takon lavdërimi më i mirë. S'ka të adhurar të denjë përveç Allahut, të sigurtë nëë adhurim ndaj Tij, edhe nëse jobesimtarët e urrejnë këtë."¹

Thotë "subhanallah" tridhjetë e tri herë, "elhamdulilah" po aq, dhe "Allahu ekber" po aq. Të njëqindtën e plotëson duke thënë: "La ilahe il-lallahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku, ue lehul

¹ Shënon Muslimi, nr. 402.

hamdu, ue huve ala kuli shejin kadir." Dhe e lexon ajetulkursinë, "Kul huvallahu ehad", "Kul eudhu bi Rabbil-Felek" dhe "Kul eudhu bi Rabbil-Nas" pas çdo namazi. Rekomandohet që këto tri sure të përsëriten tri herë pas namazit të sabahut dhe pas namazit të akshamit, sepse për këtë kanë ardhur hadithe nga Profeti ﷺ. Të gjitha këto përkujtime (dhikër) janë sunet dhe jo farz.

Është e preferuar për çdo musliman e muslimane që rregullisht të falë katër rekate para namazit të drekës dhe dy pas tij, dy rekate pas akshamit, dy rekate pas jacisë dhe dy rekate para namazit të sabahut. Të gjitha së bashku bëjnë dymbëdhjetë rekate. Këto rekate quhen sunetet e rregullta ditore (ar. es sunen er ravatib), sepse Profeti ﷺ i falte rregullisht kur nuk ishte në udhëtim. Sa i përket udhëtimit, Profeti ﷺ i linte sunetet e rregullta ditore, përveç sunetit të sabahut dhe vitrit, të cilët i falte rregullisht si kur nuk ishte në udhëtim ashtu edhe në udhëtim. Është më e preferuar që këto sunete të rregullta dhe vitri të falen në shtëpi, e nëse i fal në xhami, nuk ka ndonjë të keqe, për shkak se Profeti ﷺ ka thënë:

(أَفْضَلُ صَلَاةِ الْمَرْءِ فِي بَيْتِهِ، إِلَّا الصَّلَاةَ الْمَكْتُوبَةَ).

"Namazi më i mirë i njeriut është në shtëpinë e tij, përveç namazit farz."¹

¹ Shënon Buhariu, nr. 6860.

Falja e rregullt e këtyre rekateve është prej shkaqeve të hyrjes në Xhenet, siç thotë Profeti ﷺ:

(مَنْ صَلَّى عَشْرَةَ رَكَعَةٍ فِي يَوْمٍ وَلَيْلَةٍ، بُنِيَ لَهُ بِهِنَّ بَيْتٌ فِي الْجَنَّةِ).

"Atij që fal gjatë ditës dhe natës dymbëdhjetë rekate, Allahu do t'ia ndërtojë një shtëpi në Xhenet."¹

Nëse fal katër rekate para ikindisë, dy para akshamit dhe dy para jacisë, është mirë, sepse ka transmetim të saktë nga Profeti ﷺ që e vërteton këtë gjë. Dhe nëse fal katër rekate pas drekës dhe katër para saj, është mirë sepse Profeti ﷺ ka thënë:

(مَنْ حَافَظَ عَلَى أَرْبَعِ رَكَعَاتٍ قَبْلَ الظُّهْرِ، وَأَرْبَعٍ بَعْدَهَا حَرَّمَهُ اللَّهُ عَلَى النَّارِ).

"Atë që i fal rregullisht katër rekate para drekës dhe katër pas saj, Allahu do ta ndalojë nga zjarri i Xhehenemit."² Domethënë t'i shtojë sunetit të rregullt edhe dy rekate pas farzit të drekës, sepse suneti i rregullt është katër rekate para farzit dhe dy pas tij. Kështu që nëse shton edhe dy rekate tjera pas tij, arrihet ajo që është përmendur në hadithin e Umu Habibes (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

Suksesi vjen vetëm nga Allahu. Salavatet dhe selamet qofshin për Profetin tonë, Muhamedin, të birin e Abdullahit, familjen, shokët e tij dhe ata që i pasojnë ata në mirësi deri në Ditën e Gjykimit!

¹ Shënon Muslimi, nr. 728.

² E shënojnë Ahmedi, nr. 25547, Tirmidhiu, nr. 393 dhe Ebu Davudi nr. 1077.



رسالة الحرمين

Message of The Two Holy Mosques

Guidance content for the visitors of the Holy Mosque and
the Prophet's Mosque in languages.

